



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Raporti individual i konsultimit publik
për projektvendimin

**“Për disa ndryshime në vendimin nr.665, datë 21.9.2016 të Këshillit të Ministrave
“Për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme”.**

1. Titulli i projekt vendimit

Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr.665, datë 21.9.2016 të Këshillit të Ministrave “Për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme”.

2.Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Ky projektvendim ka për objekt rishikimin dhe përditësimin e Shtojcave I dhe IV që shoqërojnë vendimin e Këshillit të Ministrave nr.665 datë 21.9.2016 “Për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme”, me Shtojcat I dhe II, propozuar sipas këtij projektvendimi. Përditësimi i listave të kimikateve në VKM 665/2016, në përputhje me listat e kimikateve të përcaktuara në BE nga legjislacioni specifik, Rregullore 649/2012 për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme, kontribuon në mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga kimikatet e rrezikshme që importohen, eksportohen dhe i nënshtrohen njoftimit dhe procedurës PIC.

Publikimi i projektvendimit u bë në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Kohëzgjatja e konsultimit publik ishte 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publik.

Postimi për konsultim për këtë projektvendim u bë më datë 28.8.2025 dhe u mbyll më datë 25.9.2025.

3.Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat

e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Projektvendimi, në zbatim të ligjit 146/2014, i është nënshtruar procesit të konsultimit publik, në portalin “Regjistri elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”, në linkun: <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/868>

4.Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Ky projektvendim është hartuar nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë. Nuk ka patur përfshirje nga palët e interesit.

5.Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Në portalin “Regjistri elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” nuk ka pasur komente. Numri i shikimeve të këtij projektvendimi është 333.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuar a	Vendimi	Justifikimi

Projektvendimi u dërgua për mendim pranë ministrive të linjës. Komentet e dhëna nga secili institucion dhe reflektimi i tyre është argumentuar në relacionin shoqërues të projektvendimit.